

RELACION TEKNIK (PROJEKT ME PERSHKRIM)

Objekti: Mirëmbajtje me performancë : Gramsh - Mollë Grabovë (kufi Korçë) (23.7) + Gramsh - K/Drize(6.9) + K/Drize -Banje(8.7) + K/Drize -Kaçivel(Elbasan)(6.6) + Drize-Poroçan (Kanioni i Holtes) (8.7). L= 54.6 km (Kontrata 2)

- Segmentet rrugore qe mbulon kontrata**

Nr. Rrugës	Emërtimi i Segmentit	Kordinata e Fillimit	Kordinata e Mbarimit	Gjatesia	Gjerrësia
				km	m
71	Gramsh - Mollë Grabovë (kufi Korçë)	N 40°51'18.1" E 20°11'24.8"	N 40°45'02.3" E 20°20'02.6"	23.7	6.5
71	Gramsh - K/Drize.	N 40°52'32.7" E 20°11'07.1"	N 40°54'56.8" E 20°08'00.3"	6.9	7
59	K/Drize - Banje.	N 40°54'56.8" E 20°08'00.3"	N 40°58'06.5" E 20°04'22.0"	8.7	7
71	K/Drize – Kaçivel (Elbasan)	N 40°54'56.8" E 20°08'00.3"	N 40°57'23.7" E 20°08'22.7"	6.6	6
W49	Drize-Poroçan (Kanioni i Holtes)	N 40°55'23.9" E 20°08'08.9"	N 40°55'59.1" E 20°12'39.5"	8.7	6
KONTRATA 2, GJATËSIA KM				54.6	

- Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga**

Aksi Rrugor: Gramsh – Molla Grabove (Kufi Korçë) L= 23.7 km

Ne V.K.M. Nr.234 date 17.04.2024 ky aks rrugor eshte pjese e inventarit te rrugeve nacionale. Ky aks rrugor eshte pjese e aksit nacional qe lidh qytetin e Gramshit me zonen e Korçes si pjese e aksit nacional Nr 71 Korçë – Gramsh – Elbasan

Pike fillimi eshte Dalja qyteti Gramsh . Pike mbarimi eshte kufiri ndares Elbasan/Korçë

Km 11+400 – 11+700 . Zone banuar KODOVJAT , Rruga eshte me trotuare .

Rruge e re , Investim i A.Rr.Sh ne vitet e fundit. Gjendja e asfaltit eshte e mire .

Rruga kalon në terren kodrinor me relief te ndryshueshem fushor , kodrinor malor me një karrexhatë me dy kahe lëvizje , pjeserisht me Mirëmbajtje Dimërore .

Gjerresia e asfaltit eshte b= 5m. Gjerresia e rruges eshte B= 6.0m - 7.0m

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për mirembajtje te vazhdueshme.

Me vijezim horizontal ne gjendje pjeserisht te mire me 2 vija ne ane te rrruges dhe vende vende te amortizuara

Me sinjalistike vertikale e cila ka nevoje per plotesime dhe regullime si dhe nevoje per tabela vetikale te reja qe tregojne kilometrazhin e rruges.

Pergjate aksit pjeset me problemike jane trajtuar me Guardrails.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime te vazhdueshëm.

Niveli i kërkuar i shërbimit të mirembajtjes “i mirë”.

Pergjate aksit janë evidentuar dia zona me çedime


Km 0+300 cedim anesor, gjatesor.

Km 5+800 demtim trup rruge dhe nevoje per murre mbajtes

Km 7+700 , Km 13+300 cedime ne rruge, me gjatesi 10 m

Km 14+000 cedim ne rruge, me gjatesi 50 m

Foto e rruges nga google maps



Aksi Rrugor : Gramsh - K.Drize L= 6.9 km

Ne V.K.M. Nr.234 date 17.04.2024 ky aks rrugor eshte pjese e inventarit te rrugeve nacionale Pike fillimi eshte dalja e qytetit Gramsh.

Pike mbarimi eshte Kryqezimi Drize

Rruge e re , Investim i A.Rr.Sh ne vitet e fundit

Ky aks rrugor eshte pjese e aksit nacional qe lidh qytetin e Elbasanit dhe te Gramshit

Zona me shtrirje km 0+000- km 1+000, eshte zone e banuar dhe rruga eshte me trotuare nga te dyja anet si me ndricim rrugor

Gjerresia e asfaltit eshte $b=6m$. Gjersia e rruges eshte $B=7.0m - 7.5 m$

Gjendja e asfaltit eshte e mire .

Rruge me 1 karexhate kalon ne nje teren fushor kodrinor pa mirembajtje dimerore.

Me vijezim horizontal ne gjendje te mire me 3 vija. 2 vija ne ane dhe 1 vije ne mes.


E kompletuar me sinjalistike vertikale si dhe me tabela vetikale qe tregojne kilometrazhin.

Kanalet anësore, kunetat dhe tombinot kanë nevojë për mirembajtje te vazhdueshme.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime te vazhdueshëm.

Niveli i kërkuar i shërbimit te mirembajtjes “i mirë”.

Foto e rruges nga google maps





Aksi Rrugor K.Drize – Banje (Diga) L= 8.7 km

Ne V.K.M. Nr.234 date 17.04.2024 ky aks rrugor eshte pjese e inventarit te rrugeve nacionale

Pike fillimi eshte Kryqezimi Drize

Pike mbarimi eshte diga e HEC Banje

Km 8+700 pika ndarese me Elbasanit (pjese e D,R.Q.P Tirane).

Rruge e re , Investim i A.Rr.Sh ne vitet e fundit

Ky aks rrugor eshte pjese aksit nacional qe lidh qytetin e Elbasanit dhe te Gramshit

Gjerresia e asfaltit eshte $b=6m$. Gjersia e rruges eshte $B=7.0m - 7.5m$

Gjendja e asfaltit eshte e mire .

Rruge me 1 karexhate kalon ne nje teren fushor , pa mirembajtje dimerore.

Me vijezim horizontal ne gjendje te mire me 3 vija. 2 vija ne ane dhe 1 vije ne mes.

E kompletuar me sinjalistike vertikale.

Rruga e kompletuar me tabela treguese kilometrazhi nga fillimi ne fund (bardhe + blu) . SH 89

Pergjate aksit pjeset me problemte jane trajtuar me Guardrails.


Ne gjatesine tij eshte prezenca e disa urave te medha

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për mirembajtje te vazhdueshme.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime te vazhdueshëm.

Niveli i kërkuar i shërbimit te mirembajtjes eshte “i mirë”.

Foto e rruges nga google maps





Aksi Rrugor K.Drize – Kaçivel (Elbasan) L= 6.6 km

Ne V.K.M. Nr.234 date 17.04.2024 ky aks rrugor eshte pjese e inventarit te rrugeve nacionale Pike fillimi eshte Kryqezimi Drize

Pike mbarimi eshte kufiri ndares, pjese e Elbasanit

Km 6+600 pika ndarese me Elbasanit (pjese e D,R.Q.P Tirane).

Ky aks lidh zonat e banuar midis Gramshit dhe Elbasanit

Rruge e vjeter e ndertuar ne vitet 1985 , ne kohen e ndertimit te HEC BANJE

Rruge me shtresa asfalti te amortizura ,vende vende me amortizim teper te madh. Shtresa te ndertuara para shume vitesh me penetrim me gjerresi $B= 5\text{ m}$. Me amortizim te dukshem . Nevoje te vazhdueshme per Mirembajtje Rutine sidomos ne drejtim te karexhates dhe kanaleve anesore.

Shembje dhe prishje te veprave te artit (mure mbajtes e prites, shpatulla urash) etj.

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të vazhdueshëm.

I gjithë segmenti ne gjatesine tij per shkak te shtresave nuk ka vijezim horizontal

I gjithë segmenti ne gjatesine tij nuk ka sinjalistike vertikale


i gjithë segmenti ne gjatesine tij nuk ka guardrail (parmake metalike mbrojtjes)

Rruga kalon në terren kodrinor me një karrexhatë me Mirëmbajtje Dimërore .

Ky segment rrugor ka nevoje per investim te plote nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Niveli i sherbimit te mirembajtjes ne kete pjese rruge eshte Niveli Minimal

Foto e rruges nga google maps



Aksi Rrugor :K.Drize - K/Kaçivel – Poroçan - Kanioni I Holtes L= 8.7 Km

Ne V.K.M. Nr.234 date 17.04.2024 ky aksi rrugor eshte pjese e inventarit te rrugeve nacionale
 Pike fillimi eshte K/ Drize & Kryqezimi Kaçivel
 Pike mbarimi eshte fundi i asfaltit ne vijim te aksit me pike fundore Kanioni I Holtes

Lidh zonen e Gramshit, aksin nacional Gramsh – Elbasan me zonen turistike te Holtes.
 Rruge e re e ndertuar ne vitet 2008 me investim te F.SH.ZH. Km 8+700 fundi i asfaltit
 Gjerresia e trupi te rruges varion , B = 5.0m – 6.0 m
 Gjerresia e karexhates te asfaltuar te rruges varion b= 4.0m – 4.5 m
 I gjithë aksi paraqitet ne gjendje te mire te pjeses kaluese te asfaltuar te rruges
 I gjithë segmenti ne gjatesine tij nuk ka vijezim horizontal
 Ne gjatesine tij ka Sinjalistike Vertikale ne gjendje te amortizuar dhe me nevoje per plotesime
 I gjithë segmenti ne gjatesine tij nuk ka guardrail (Parrake Metalike Mbrojtjes)
 I gjithë segmenti ne gjatesine tij kalon ne zona te banuar fshati Kotorr dhe lidh disa kryqezime te
 ndryshme te fshatrave perreth si n kryqezimi Gjergjevine , Bardhaj ,etj
 Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të vazhdueshëm.
 Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.
 Niveli i kërkuar i shërbimit te mirembajtjes eshte “i mirë”.

Zona Problematike pergjate rruges


Km 5+050. Zone me çedime ne trupin e rruges.

Km 5+150 Ura mesatare , pa parrake mbrojttese dhe orientuese metalike.

Zona me shkarje anesore nga skarpata anesore ne trupin e rruge, shembje me volume sidomos ne ditet me rreshje . Km 3+100 km 4+400 , km 6+100.

Km 7+950 Ura e madhe, BARDHAJ, Ka nevoje per punime mbrojttese me kosha gabioni ose me struktura betoni ne pjesen anesore te trupit te rruges dhe ures ne ane e majte te ures per mbrojtjen e ures ne vershimet e ujit sidomos ne ditet me rreshje dhe rrebeshe shiu.

Foto e rruges nga google maps





GRUPI I PUNËS